

LIGJ
Nr. [.] /2026

“PËR BYROTË E KREDITIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon krijimin, licencimin dhe funksionimin e byrove të kreditit në Republikën e Shqipërisë, si dhe kriteret për përpunimin e të dhënave në veprimtaritë e raportimit kreditor.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë disponueshmërinë e informacionit të besueshëm kreditor, të garantojë një vlerësim të saktë dhe të rregullt të besueshmërisë kreditore të personave juridikë dhe fizikë, si dhe të kontribuojë në nxitjen e kredithënies dhe kredimarrjes së ndershme e të përgjegjshme.

Neni 3

Fusha e zbatim

1. Ky ligj zbatohet për mbledhjen, regjistrimin, shpërndarjen, përdorimin dhe çdo formë tjetër përpunimi të informacionit kreditor nga byrotë e kreditit, në kuadër të veprimtarisë të tyre tregtare.

2. Ky ligj nuk zbatohet kur një subjekt shpërndan informacion në kuadër të një detyrimi që buron nga një ligj ose akt nënligjor.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Besueshmëri kreditore" është probabiliteti që subjekti i të dhënave do të përmbushë detyrimet në përputhje me marrëveshjen e kredisë.

2. "Të dhëna të mbyllura", në kuptim të këtij ligji, janë të dhënat ose informacioni kreditor që administrohet ose ruhet në regjistra, baza të dhënash ose sisteme informacioni të mbajtura nga autoritete publike, institucione shtetërore ose ofrues të të dhënave, aksesit në të cilat nuk është publik dhe lejohet vetëm në rastet, kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ky ligj ose nga legjislacioni tjetër i zbatueshëm.

Të dhënat e mbyllura përfshijnë, ndër të tjera, informacionin që lidhet me:

a) ekzistencën, përmbajtjen, përmbushjen ose mos përmbushjen e detyrimeve financiare ose kontraktore të subjektit të të dhënave;

b) historikun e pagesave, detyrimeve të prapambetura, mos përmbushje të detyrimeve;

c) marrëdhëniet kreditore ose financiare të subjektit të të dhënave; dhe

ç) çdo informacion tjetër kreditor që nuk është i ruajtur në të dhëna të hapura dhe që përpunohet në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. "Marrëveshje kredie" është çdo veprim juridik ndërmjet kredidhënësit, kredimarrësit dhe/ose çdo personi tjetër që merr përsipër detyrime apo garanci lidhur me përmbushjen e detyrimeve financiare, e cila krijon ose garanton një detyrim për pagesën ose shlyerjen e një shume të hollash, me ose pa interes, brenda një periudhe të caktuar kohe, përfshirë, por pa u kufizuar në, kontratat e kredisë, linjat e kredisë, overdraftet, kontratat e qirasë financiare (leasing), marrëveshjet për pagesa të shtyra në kohë, garancitë personale ose reale, dorëzanitë, hipotekat, si dhe çdo angazhim tjetër financiar me efekt ekonomik të ngjashëm."

4. "Byro krediti" janë personat juridikë të themeluar në formën e shoqërive aksionare dhe që ushtrojnë veprimtari në përputhje me kërkesat e këtij ligji, të cilat mbledhin, përpunojnë, ruajnë dhe administrojnë të dhëna mbi historikun e kredisë, detyrimet financiare, sjelljen paguese dhe aftësinë kredimarrëse të personave fizikë dhe personave juridikë, të përfutuara nga burime të autorizuar të të dhënave. Byrotë e kreditit vendosin në dispozicion këto të dhëna të përpunuara për përdoruesit e të dhënave, për qëllime të vlerësimit të sjelljes paguese dhe aftësisë kredimarrëse të subjektit të të dhënave me të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në marrëdhënie kontraktore.

5. "Historik kreditor" është një informacion i strukturuar mbi subjektin e të dhënave në lidhje me përmbushjen e detyrimeve kreditore të shkuara.

6. "Renditje kreditore" është njësia matëse e besueshmërisë kreditore, e nxjerrë nga sintetizimi dhe analizimi i të dhënave bazuar vetëm në një sistem ose model statistikor të paracaktuar.

7. "Raport kreditor" është një dokument i përgatitur nga Byroja e kreditit me kërkesë të përdoruesit të të dhënave, i cili përfshin të gjithë ose një pjesë të informacionit që përmban historiku kreditor i subjektit të të dhënave.

8. "Informacion kreditor" nënkupton çdo të dhënë pozitive ose negative që lidhet me besueshmërinë kreditore, historikun e pagesave, gjendjen e detyrimeve financiare, profilin kreditor ose ekspozimin financiar të një subjekti të të dhënave në lidhje me një marrëdhënie kredie, garancie ose çdo marrëdhënie tjetër financiare, qoftë si kredimarrës, bashkëkredimarrës, dorëzanës, hipotekues apo në çdo cilësi tjetër që krijon, garanton ose siguron përmbushjen e një detyrimi monetar.

9. "Ofrues të dhënash" në kuptim të këtij ligji është kontrolluesi sipas kuptimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, transmeton informacion kreditor të subjektit të të dhënave në Byronë e kreditit, në përputhje me këtë ligj dhe marrëveshjen e lidhur për këtë qëllim ndërmjet ofruesit të të dhënave dhe Byrosë së Kreditit.

10. "Subjekt i të dhënave", në kuptim të këtij ligji, është çdo person fizik ose juridik për të cilin përpunohet informacion kreditor nga një përdorues i të dhënave ose nga Byroja e kreditit, në lidhje me vlerësimin, krijimin, administrimin, garantimin ose përmbushjen e një marrëdhënieje kredie apo detyrimi financiar.

11. "Përdorues i të dhënave" është çdo ofrues të dhënash që ka lidhur një marrëveshje me shkrim me Byronë e kreditit për të transmetuar dhe marrë shërbime të informacionit kreditor.

12. "Ligji për licencat, autorizimet dhe lejet" nënkupton Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

13. "Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" nënkupton kuadrin ligjor që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale.

14. "Informacion kreditor pozitiv" është informacioni që tregon se një subjekt të dhënash ka përmbushur ose po përmbush detyrimet e tij financiare në mënyrë të plotë dhe në kohë.

15. "Informacion kreditor negativ" është informacioni që tregon se një subjekt të dhënash nuk ka përmbushur detyrimet e tij financiare, ku përfshihen vonesat në përmbushjen e detyrimeve, gjendja e aftësisë paguese dhe të dhëna të tjera të ngjashme.

16. "Institucione financiare jo-banka" do të kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", por do të përfshijnë edhe shoqëritë e kursim-kreditit sipas përcaktimit të Ligjit nr. 52/2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre".

17. "Të dhëna personale" kanë të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

18. Të dhëna të hapura", në kuptim të këtij ligji, janë të dhënat ose informacionet e marra nga regjistra publikë, baza të dhënash publike ose burime të tjera zyrtare, aksesit në të cilat është i lejuar pa kufizime të posaçme ligjore për publikun ose për kategori të caktuara personash, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat e hapura përfshijnë vetëm ato të dhëna që:

a) janë bërë publike ose të aksesueshme në mënyrë të ligjshme nga autoritetet publike ose subjektet që i administrojnë;

b) mund të përdoren për qëllimet e parashikuara në këtë ligj; dhe

c) nuk i nënshtrohen ndalimeve ose kufizimeve të posaçme për akses, përdorim ose ripërdorim sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretit profesional, sekretit tregtar ose legjislacionit tjetër të zbatueshëm.

19. "Përpunimi i informacionit kreditor" është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

Neni 5

Parime

Veprimtaritë e raportimit kreditor, për sa kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale i përmbahen të njëjtave parime me ato të parashikuara në ligjin Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që janë:

a) parimi i ligjshmërisë, i drejtësisë dhe i transparencës;

- b) parimi i minimizimit të të dhënave;
- c) parimi i përpunimit në përputhje me qëllimin;
- ç) parimi i saktësisë së të dhënave;
- d) parimi i kufizimit të ruajtjes në kohë të të dhënave;
- dh) parimi i integritetit dhe i konfidencialitetit;
- e) parimi i përgjegjshmërisë

KREU II MBLEDHJA E INFORMACIONIT KREDITOR

Neni 6

Burimet e informacionit kreditor

1. Byrotë e kreditit mund të mbledhin informacion kreditor vetëm nga burimet e mëposhtme:
 - a) informacion i transmetuar nga ofruesi i të dhënave, në përputhje me këtë ligj;
 - b) informacion i marrë nga të dhëna të mbyllura apo të hapura ;
 - c) informacion i transmetuar drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave.

2. Transmetimi i informacionit pranë Byrosë së kreditit nga ofruesi i të dhënave kryhet në bazë të një marrëveshjeje me shkrim të lidhur paraprakisht ndërmjet Byrosë së kreditit dhe ofruesit të të dhënave. Marrëveshja duhet të parashikojë detyrimisht:

- a) llojin e të dhënave të transmetuara;
- b) kushtet lidhur me transmetimin e të dhënave;
- c) mënyrën e transferimit të të dhënave;
- ç) kufizimet për përdorimin e informacionit dhe raporteve kreditore; dhe
- d) masat tekniko - organizative për sigurinë e të dhënave.

3. Asnjë informacion tjetër, përveç atij të marrë nga këto burime, nuk mund të përpunohet gjatë veprimtarive të raportimit kreditor.

Neni 7

Ofruesit e të dhënave

1. Ofruesit e të dhënave janë:
 - a) Bankat;
 - b) Institucionet e Pagesave;
 - c) Institucionet e Parasë Elektronike
 - ç) Ofruesit e tjerë të Shërbimit të Pagesave;
 - d) Institucionet financiare jo-banka;
 - dh) Shoqëritë e kursim-kreditit;
 - e) Unionet e shoqërive të kursim-kreditit;
 - ë) Shoqëritë e Sigurimit;
 - f) Banka e Shqipërisë;
 - g) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - gj) Drejtoritë Rajonale Tatimore;
 - h) Njësitë e Qeverisjes Vendore (Taksat dhe Tarifat);

- i) Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes të energjisë elektrike, gazit ujësjellës-kanalizime dhe të komunikimeve elektronike dhe postare;
- j) Persona të tjerë juridikë që furnizojnë mallra dhe shërbime që rezultojnë në detyrime për personat juridikë dhe personat fizikë.

2. Ofruesit e të dhënave që përpunojnë të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e një kontrate, ku subjekti i të dhënave është palë, ose për marrjen e masave që paraprijnë lidhjen e një kontrate me kërkesë të subjektit të të dhënave, kanë të drejtë t'ia transmetojnë këto të dhëna Byrosë së Kreditit për qëllime të raportimit kreditor, vlerësimit të aftësisë paguese dhe administrimit të riskut kreditor, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet ofruesit të të dhënave dhe Byrosë së Kreditit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për qëllime të krijimit të bazës fillestare të të dhënave të Byrosë së Kreditit, Banka e Shqipërisë, me kërkesë të Byrosë së Kreditit dhe në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet tyre për këtë qëllim, i vë në dispozicion Byrosë së Kreditit informacionin kreditor të administruar në Regjistrin e Kredive deri në datën e licencimit të Byrosë së Kreditit, në masën dhe sipas kushteve, kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 8

Mënyra e transmetimit

Informacioni kreditor i transmetohet Byrosë së kreditit në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

- a) në formë të shkruar, vërtetuar me vulën e ofruesit të të dhënave dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të tij, në adresën e regjistruar të Byrosë së kreditit ose në çdo adresë tjetër për të cilën është rënë dakord;
- b) në rrugë elektronike, në mënyrë të tillë që të dhënat të transferohen në mënyrë të sigurt.

Neni 9

Përmbajta e Historikut Kreditor për Personat Fizikë

Bazuar në parimin e minimizimit të të dhënave, historiku kreditor i një subjekti të dhënash person fizik mund të përfshijë, pa u kufizuar vetëm në to, kategoritë e të dhënave të përcaktuara në këtë nen dhe çdo kategori tjetër të dhënash vetëm në masën që lejohet dhe është e nevojshme sipas parashikimeve të këtij ligji:

- a) emri i plotë (emër, mbiemër) dhe data e lindjes;
- b) të dhënat e kartës së identitetit dhe të pasaportës;
- c) adresa e vendbanimit;
- ç) informacion mbi statusin e punësimit;
- d) informacion në lidhje me kërkesat për kredi, duke përfshirë datën e kërkesës, vlerën e kërkuar, qëllimin, llojin dhe vlerën e garancisë së dhënë, si dhe emrin dhe adresën e kreditorit;

- dh) informacion për marrëveshjen e lidhur të kredisë dhe çdo ndryshim të saj, përfshirë por pa u kufizuar në datën e lidhjes së marrëveshjes, ekstremitetet numerike, palët, qëllimin e përdorimit etj;
- e) vlerën fillestare të detyrimit sipas marrëveshjes së lidhur të kredisë;
- ë) monedhën në të cilën do të përmbushet detyrimi;
- f) afatin dhe procedurën e ekzekutimit të marrëveshjes së kredisë;
- g) informacion në lidhje me detyrimet e prapambetura sipas marrëveshjes së kredisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në datën e maturimit, vlerën e papaguar, ristrukturime apo të dhëna të tjera që lidhen me detyrimet e prapambetura;
- gj) informacion mbi përfundimin e marrëveshjes së kredisë dhe mënyrën e përfundimit të saj duke përfshirë, por pa u kufizuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve për këtë qëllim, vendimin e gjykatës, përmbushjen nga dorëzanësi apo të dhëna të tjera të ngjashme;
- h) datën kur informacioni mbi detyrimin e prapambetur është përfshirë në bazën e të dhënave të Byrosë së kreditit dhe datën kur ky informacion është përditësuar për herë të fundit;
- i) informacion që tregon se detyrimi është shlyer plotësisht, përfshirë datën nga e cila detyrimi nuk ekziston më;
- j) informacion nëse subjekti i të dhënave ka shprehur kundërshtime me shkrim kundër ekzistencës ose vlerës së detyrimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në informacionin në lidhje me mosmarrëveshjet gjyqësore ose në arbitrazh mbi marrëveshjen e kredisë ose kundërshtime të procedurës së ekzekutimit nga përmbartimi gjyqësor;
- k) renditjen kreditore
- l) ekzistenca e detyrimeve të prapambetura tatimore ose në pagesa të tjera të detyrueshme;
- ll) vendime gjyqësore lidhur me lindjen, ekzekutimin dhe shuarjen e detyrimeve nga marrëveshjet e lidhura të kredisë;
- m) informacione të tjera që tregojnë aftësinë e subjektit të të dhënave për të përmbushur detyrimet e veta;
- n) përditësimi i fundit i historikut kreditor;
- nj) informacione lidhur me ofruesin e të dhënave, i cili ka transmetuar informacionin pranë Byrosë së kreditit;
- o) informacione të tjera të përpunuara në përputhje me Ligjin Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Neni 10

Përmbajtja e Historikut Kreditor për Personat Juridikë

Historiku kreditor i një subjekti të dhënash person juridik mund të përfshijë, pa u kufizuar vetëm në to, kategoritë e të dhënave të përcaktuara në këtë nen dhe, për sa këto të dhëna lidhen me përpunimin e të dhënave personale, çdo kategori tjetër të dhënash vetëm në masën që lejohet dhe është e nevojshme sipas parashikimeve të këtij ligji:

- a) emër i plotë, i shkurtuar dhe tregtar (nëse ka);
- b) adresën e regjistruar dhe informacionin e kontaktit të publikuar nga personi juridik (telefon, faks, e-mail);
- c) NUIS të personit juridik;
- ç) objektin e veprimtarisë dhe kodin NVE;

- d) emrin e plotë të përfaqësuesit ligjor;
- dh) informacion në lidhje me kërkesat për kredi, duke përfshirë datën e kërkesës, vlerën e kërkuar, qëllimin, llojin dhe vlerën e garancisë së dhënë, emrin dhe adresën e kreditorit;
- e) informacion për marrëveshjen e lidhur të kredisë dhe çdo ndryshim të saj, përfshirë por pa u kufizuar në datën e lidhjes së marrëveshjes, ekstremitetet numerike, palët, qëllimin e përdorimit etj.;
- ë) vlerën fillestare të detyrimit sipas marrëveshjes së lidhur të kredisë;
- f) monedhën në të cilën do të përmbushet detyrimi;
- g) afatin dhe procedurën e ekzekutimit të marrëveshjes së kredisë;
- gj) informacion mbi vlerën e paguar dhe vlerën e mbetur të detyrimit;
- h) informacion në lidhje me detyrimet e prapambetura sipas marrëveshjes së kredisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në datën e maturimit, vlerën e papaguar etj;
- i) informacion mbi përfundimin e marrëveshjes së kredisë dhe mënyrën e përfundimit të saj duke përfshirë, por pa u kufizuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve për këtë qëllim, vendimin e gjykatës, përmbushjen nga dorëzanësi, etj;
- j) datën kur informacioni mbi detyrimin e prapambetur është përfshirë në bazën e të dhënave të Byrosë së kreditit dhe datën kur ky informacion është përditësuar për herë të fundit;
- k) informacion që tregon se detyrimi është shlyer plotësisht, duke përfshirë datën nga e cila detyrimi nuk ekziston më;
- l) informacion nëse subjekti i të dhënave ka shprehur kundërshtime me shkrim kundër ekzistencës ose vlerës së detyrimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në informacionin në lidhje me mosmarrëveshjet gjyqësore ose në arbitrazh mbi marrëveshjen e kredisë etj;
- ll) renditjen kreditore;
- m) informacione për procedurat e falimentimit, likuidimit dhe/ose riorganizimit;
- n) informacione që tregojnë performancën financiare të subjektit të të dhënave;
- nj) ekzistenca e detyrimeve të prapambetura tatimore ose në pagesa të tjera të detyrueshme;
- o) vendime gjyqësore në lidhje me lindjen, ekzekutimin dhe shuarjen e detyrimeve sipas marrëveshjeve të lidhura të kredisë;
- p) informacione të tjera që tregojnë aftësinë e subjektit të të dhënave për të përmbushur detyrimet e veta.
- q) data e përditësimit të historikut kreditor;
- r) informacione lidhur me ofruesin e të dhënave, i cili ka transmetuar informacionin pranë Byrosë së kreditit;
- s) informacione të tjera të përpunuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Trajtim i barabartë i subjekteve të të dhënave

Byrotë e kreditit sigurojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjitha subjekteve të të dhënave, informacioni kreditor i të cilëve përpunohet në përputhje me këtë ligj. Çdo mbledhje, ruajtje, përpunim, vlerësim ose shpërndarje e informacionit kreditor duhet të kryhet mbi baza objektive, proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale

KREU III

PROCEDURA PËR DHËNIEN E RAPORTIT KREDITOR

Neni 12

Përgatitja e një raporti kreditor

1. Byrotë e kreditit përpunojnë të dhënat e mbledhura dhe japin informacion në formën e raporteve kreditore. Raportet kreditore përmbajnë të gjithë informacionin e historikut kreditor, përveç nëse përdoruesi i të dhënave ose subjekti i të dhënave kërkon vetëm pjesë të caktuara të tij.
2. Byrotë e kreditit nuk mund të përgatitin një raport mbi subjektin e të dhënave pa një kërkesë nga një përdorues ose nga vetë subjekti i të dhënave.
3. Raporti duhet të përmbajë vetëm informacione për subjektin e të dhënave dhe nuk duhet të përfshijë informacione për persona të tjerë të lidhur me të, ose në rastin e personave juridikë, informacion mbi detyrimet financiare të përfaqësuesve ligjorë dhe/ose ortakëve të tij, përveç rasteve kur ata shprehin pëlqimin e tyre në përputhje me këtë ligj.
4. Byrotë e kreditit janë të detyruara të publikojnë në faqet e tyre zyrtare formatet e raporteve që përdoren për përgatitjen e raporteve kreditore.

Neni 13

Kërkesa për marrjen e një raporti kreditor

1. Përdoruesi i të dhënave ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion kreditor nga Byroja e kreditit, nëse ekziston një nga kushtet e mëposhtme:
 - a) përdoruesi i të dhënave ka lidhur një marrëveshje kredie me subjektin e të dhënave;
 - b) subjekti i të dhënave ka kontaktuar përdoruesin e të dhënave, ose palët janë në negociatë, me qëllim të lidhjes së një marrëveshje kredie;
 - c) në çdo rast tjetër nëse subjekti i të dhënave ka rënë dakord ose ka kërkuar që përdoruesi i të dhënave të vlerësojë ose të marrë në konsideratë besueshmërinë e tij kreditore në ofrimin e një shërbimi me rrezik kreditor ose në marrjen e një vendimi për të ofruar një shërbim të tillë.
2. E drejta e përdoruesit të të dhënave për të pasur akses në raportin kreditor ushtrohet:
 - a) gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes së lidhur, në rastin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni;
 - b) përgjatë kohëzgjatjes së negociatave, në rastin e parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të këtij neni;
 - c) deri në përmbushjen e qëllimit përkatës, në rastin e parashikuar nga shkronja “c” e këtij neni.
3. Nëse ekziston një nga rastet e përcaktuara në paragrafin 1, Byroja e Kreditit dhe përdoruesi i të dhënave duhet të lidhin një marrëveshje me shkrim për përgatitjen e raportit kreditor.
4. Marrëveshja ndërmjet përdoruesit të të dhënave dhe Byrosë së Kreditit duhet të përmbajë:
 - a) arsyet përse kërkohet raporti kreditor;
 - b) mënyrën e transferimit të të dhënave;
 - c) tarifën e shërbimit;
 - c) detyrimet e palëve në lidhje me përpunimin e të dhënave; dhe
 - dh) çdo dispozitë tjetër që nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Refuzimi për të paraqitur një raport

1. Byrotë e kreditit do të refuzojnë t'i paraqesin një raport kreditor përdoruesit të të dhënave nëse ndonjë nga parakushtet e përcaktuara në nenet e mësipërme nuk përmbushet.
2. Pavarësisht parashikimit të paragrafit 1, do të refuzohet dhënia e informacionit kreditor nëse ka rrethana të arsyeshme për të dyshuar se informacioni do të përdoret nga një person tjetër përveç atij që ka të drejtën ta marrë atë në përputhje me këtë ligj, ose për qëllime të ndryshme nga ato që lidhen me arritjen dhe zbatimin e marrëveshjes së kredisë.

Neni 15

Renditja Kreditore

1. Nëse kërkohet nga përdoruesi i të dhënave, renditja kreditore mund të përfshihet si pjesë e raportit kreditor, në përputhje me nenet 12 dhe 13 të këtij ligji.
2. Për përgatitjen e renditjes kreditore, Byroja e Kreditit përdor një ose disa modele statistikore, matematikore ose algoritmike, të hartuara në përputhje me metodologjitë, standardet teknike dhe praktikatat e njohura për sistemet e raportimit kreditor që operojnë në vendet e Bashkimit Evropian.
3. Modelet e përdorura për përgatitjen e renditjes kreditore duhet të bazohen në kritere objektive, proporcionale, të verifikueshme dhe jo diskriminuese, duke garantuar saktësinë, integritetin dhe besueshmërinë e vlerësimit kreditor.
4. Byroja e Kreditit ka detyrimin të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit:
 - a) kategoritë kryesore të modeleve të përdorura për renditjen kreditore;
 - b) informacion të përgjithshëm mbi metodologjitë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në renditjen kreditore;
 - c) shpjegime të përgjithshme dhe shembuj ilustrues mbi mënyrën e funksionimit të renditjes kreditore, në masën që kjo nuk cenon sekretin tregtar, sigurinë e sistemit ose të drejtat e pronësisë intelektuale.
5. Përdoruesi i të dhënave mund të zgjedhë një ose disa modele të renditjes kreditore të ofruara nga Byroja e Kreditit në momentin e paraqitjes së kërkesës për marrjen e raportit kreditor.
6. Në rastet kur renditja kreditore përdoret si pjesë e një procesi të automatizuar vendimmarrjeje që prodhon efekte juridike ose ndikon në mënyrë të konsiderueshme mbi subjektin e të dhënave, zbatohen garancitë dhe të drejtat e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Kodi i Sjelljes i miratuar në përputhje me nenin 35 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mund të përcaktojë rregulla të detajuara lidhur me:

- a) metodologjitë dhe kriteret për përgatitjen e renditjes kreditore;
- b) kërkesat teknike dhe organizative për modelet e renditjes kreditore;
- c) standardet e transparencës dhe shpjegueshmërisë së renditjes kreditore;
- ç) masat për garantimin e saktësisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;
- d) mënyrën e përdorimit të renditjes kreditore nga përdoruesit e të dhënave; dhe
- dh) çdo aspekt tjetër të nevojshëm për funksionimin e drejtë, transparent dhe të sigurt të sistemeve të renditjes kreditore.

Neni 16

Mënyra e marrjes së raportit kreditor

1. Raporti kreditor ndahet me përdoruesin e të dhënave ose subjektin e të dhënave, me kërkesë të tyre, në njërën nga format e mëposhtme:
 - a) në formë të shkruar, vërtetuar me vulën e Byrosë së kreditit dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të saj, në adresën e regjistruar të subjektit/përdoruesit të të dhënave ose në çdo adresë tjetër të rënë dakord prej tyre;
 - b) në rrugë elektronik, në mënyrë të tillë që të dhënat të transmetohen në mënyrë të sigurt.
2. Raporti kreditor do të dorëzohet brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet përdoruesit të të dhënave dhe Byrosë së kreditit.

KREU IV

DETYRIMET E BYROVE TË KREDITIT DHE OFRUESVE TË TË DHËNAVE

Neni 17

Përgjegjësitë e ofruesve të të dhënave

1. Ofruesi i të dhënave është përgjegjës për:
 - a) marrjen e të gjitha masave për paraqitjen e një informacioni të plotë dhe të saktë pranë Byrosë së kreditit;
 - b) transmetimin pranë Byrosë së kreditit informacione për të cilat është në dijeni ose ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se janë të pasakta, të rreme ose të paplota;
 - c) kryerjen e korrigjimeve dhe përditësimin e informacionit të dhënë për subjektet e të dhënave.
2. Ofruesi i të dhënave, i cili pas dorëzimit të informacionit në Byronë e kreditit, konfirmon se ky informacion është i paplotë dhe/ose i pasaktë, njofton menjëherë Byronë e kreditit për këtë dhe i paraqet të gjitha korrigjimet përkatëse dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm që të dhënat të jenë të plota dhe të sakta.
3. Nëse subjekti i të dhënave ka kundërshtuar plotësinë ose saktësinë e informacionit të dorëzuar në Byronë e kreditit përpara ofruesit të të dhënave, ky i fundit është i detyruar të njoftojë menjëherë Byronë e kreditit dhe të kryejë një hetim.
4. Ofruesi i të dhënave pas marrjes së njoftimit nga subjekti i të dhënave që kundërshton plotësinë ose saktësinë e informacionit:
 - a) kontrollon informacionin e kundërshtuar;
 - b) shqyrton të gjitha faktet për përcaktimin e bazueshmërisë së kërkesës;
 - c) i njofton rezultatet e hetimit subjektit të të dhënave dhe Byrosë së kreditit brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 18

Përgjegjësitë e byrove të kreditit

1. Byroja e kreditit është përgjegjëse për përputhshmërinë e informacionit të përfshirë në bazën e saj të të dhënave me informacionin e dhënë nga ofruesit e të dhënave.
2. Byroja e kreditit nuk mban përgjegjësi për plotësinë dhe vërtetësinë e informacionit që është marrë nga ofruesi i të dhënave ose nga të dhënat e hapura ose të mbyllura në përputhje me këtë ligj, nëse pa ndryshuar përmbajtjen, ia ka transferuar atë përdoruesit të të dhënave.

3. Byroja e kreditit nuk mban përgjegjësi për vendimet e marra nga përdoruesi i të dhënave ndaj subjektit të të dhënave, bazuar plotësisht ose pjesërisht në informacionin që përmban raporti, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1, kur në mënyrë të paligjshme dhe me faj, ka transferuar të dhëna të rreme, të pasakta ose të paplota.

Neni 19

Regjistri i kërkesave

1. Byrotë e kreditit duhet të mbajë një regjistër elektronik të të gjitha kërkesave për marrjen e raporteve kreditore të depozituara nga përdoruesit e të dhënave.

2. Kërkesat e regjistruara do të ruhen për një periudhë pesë vjeçare.

Neni 20

Përpunimi i të dhënave nga palët e treta dhe kufizimi i transmetimit të informacionit kreditor

1. Byroja e kreditit mund të angazhojë palë të treta për ofrimin e shërbimeve teknike, operative ose mbështetëse që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së saj, përfshirë ruajtjen, administrimin, përpunimin ose transmetimin e informacionit kreditor, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në çdo rast, Byroja e kreditit mbetet përgjegjëse për ligjshmërinë, sigurinë dhe përputhshmërinë e përpunimit të kryer nga këto palë të treta.

2. Përdoruesit e të dhënave dhe çdo person tjetër që ka akses në informacion kreditor në bazë të këtij ligji nuk mund t'ua transmetojnë, zbulojnë ose vënë në dispozicion informacionin kreditor palëve të treta, përveç rasteve kur:

- a) një transmetim i tillë lejohet shprehimisht nga ky ligj ose nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale; ose
- b) transmetimi kryhet për qëllime të lidhura drejtpërdrejt me administrimin, ekzekutimin ose garantimin e marrëdhënies së kredisë dhe në përputhje me masat e përshtatshme të konfidencialitetit dhe sigurisë.

Neni 21

Ruajtja e të dhënave

1. Byroja e kreditit ruan të dhënat e mbledhura për një subjekt të dhënash sipas afateve të përcaktuara më poshtë:

- a) të dhënat pozitive — deri në 3 (tre) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së kredisë ose e kontratës përkatëse;
- b) të dhënat negative — deri në 5 (pesë) vjet nga data e përmbyshjes ose shuarjes së detyrimit përkatës.

2. Afatet e ruajtjes mund të shkurtohen dhe të dhënat mund të fshihen përpara përfundimit të afateve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në rastet e mëposhtme:

- a) kur mungon ose është e pavlefshme marrëveshja e kredisë ose marrëveshja ndërmjet Byrosë së kreditit dhe ofruesit të të dhënave;
- b) kur informacioni është marrë nga burime të tjera përveç atyre të lejuara me ligj, ose nuk është transmetuar në përputhje me procedurat ligjore të parashikuara në këtë ligj;

- c) me përfundimin e një periudhe më të shkurtër ruajtjeje të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
- ç) kur konstatohet se informacioni është i pasaktë;
- d) në çdo rast tjetër të parashikuar nga ky ligj ose nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Me fshirjen e të dhënave për ndonjë nga arsyet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Byroja e kreditit njofton ofruesin përkatës të të dhënave dhe kur është rasti dhe vetë subjektin e të dhënave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga veprimi i fshirjes.

4. Afatet e përcaktuara në pikën 1 më sipër, si dhe kategoritë e informacioneve kreditore, mund të përcaktohen ndryshe në Kodin e Sjelljes në kuptim të Nenit 35 të Ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 22

Transferimi i informacionit pas përfundimit të aktivitetit

1. Kur një Byro krediti përfundon aktivitetin e saj, informacioni i ruajtur fshihet në mënyrë të përhershme ose transferohet në një Byro tjetër krediti.

2. Transferimi i të dhënave ndërmjet byrove të kreditit do të bëhet në përputhje me Ligjin "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Neni 23

Kufizimi i qëllimit

Të gjitha subjektet që kanë akses në informacionin dhe raportet kreditore janë të detyruara t'i mbajnë dhe t'i përdorin ato ekskluzivisht për qëllimet që janë marrë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

Mbrojtja e të dhënave

1. Gjatë përpunimit të të dhënave të transmetuara, Byroja e kreditit dhe përdoruesit e të dhënave janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave dhe të ndërmarrin të gjitha masat e duhura administrative, teknike dhe organizative për të mundësuar disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave.

2. Përpunimet e të dhënave personale për qëllimet e këtij ligji, do të kryhen në zbatim të parashikimeve të Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Neni 25

Sekreti profesional dhe konfidencialiteti

1. Informacioni kreditor që lidhet me subjektet e të dhënave është informacion konfidencial. Byroja e kreditit, ofruesit e të dhënave, përdoruesit e të dhënave, si dhe çdo person që ka akses në këtë informacion në ushtrim të funksioneve të tij, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e tij dhe nuk mund ta përdorin ose zbulojnë atë, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ky ligj ose legjislacioni në fuqi.

2. Çdo person që, gjatë ushtrimit të detyrave ose funksioneve të lidhura me veprimtarinë e raportimit të kreditit, merr dijeni për informacione ose fakte që lidhen me subjektet e të dhënave,

është i detyruar të ruajë sekretin profesional dhe nuk mund t'ia zbulojë ato asnjë pale të tretë, përveç rasteve të autorizuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.

KREU V TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 26

Detyrimi për Informim mbi Përpunimin e Informacionit Kreditor

1. Në çdo rast të përpunimit të të dhënave personale për qëllime të raportimit kreditor, vlerësimit të aftësisë paguese, krijimit të raportit kreditor, ofruesi i të dhënave, është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe transparente se të dhënat e tij personale do të përpunohen për këto qëllime.

2. Informimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet:

- a) në momentin e mbledhjes së të dhënave personale nga subjekti i të dhënave; ose
- b) kur të dhënat nuk mblidhen drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Njoftimi duhet të përmbajë të paktën:

- a) identitetin dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit të të dhënave, dhe sipas rastit, të Byrosë së Kreditit;
- b) qëllimet e përpunimit të informacionit kreditor dhe bazën ligjore të përpunimit;
- c) kategoritë e të dhënave personale që do të përpunohen;
- ç) kategoritë e përdoruesve të informacionit kreditor;
- d) ekzistencën e procesit të renditjes kreditore ose të vendimmarrjes së automatizuar, kur aplikohet, si dhe informacion të përgjithshëm mbi logjikën e përdorur dhe pasojat e mundshme për subjektin e të dhënave;
- dh) periudhën e ruajtjes së të dhënave personale ose kriteret për përcaktimin e saj;
- e) të drejtat e subjektit të të dhënave sipas këtij ligji dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë të drejtën për akses, korrigjim, përditësim, kufizim të përpunimit, kundërshtim dhe paraqitje ankese pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ë) informacion mbi karakterin e detyrueshëm ose vullnetar të dhënies së të dhënave dhe pasojat e mundshme të mosdhënies së tyre;
- f) informacion mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, kur aplikohet.

4. Informacioni sipas këtij neni duhet të jepet në një formë të qartë, të dallueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

5. Njoftimi i dhënë sipas këtij neni konsiderohet i vlefshëm edhe për përpunimet e mëvonshme të informacionit kreditor të kryera nga Byroja e Kreditit dhe Ofruesit e të dhënave, për aq kohë sa:

- a) këto përpunime kryhen për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj;
- b) subjekti i të dhënave është informuar paraprakisht mbi ekzistencën e sistemit të raportimit kreditor dhe kategoritë e përdoruesve të të dhënave; dhe
- c) nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore qëllimet ose baza ligjore e përpunimit.

6. Nuk kërkohet njoftim i ri ndaj subjektit të të dhënave për çdo aksesim, konsultim ose shkëmbim individual të raportit kreditor nga përdoruesit e autorizuar të të dhënave, për sa kohë që përpunimi kryhet në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

7. Byroja e kreditit është e detyruar të mbajë regjistra të aksesimeve dhe konsultimeve të raportit kreditor dhe t'ia vërë ato në dispozicion subjektit të të dhënave, me kërkesën e tij, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Subjekti i të dhënave ka të drejtë, në çdo kohë, të kërkojë informacion shtesë lidhur me përpunimin e të dhënave të tij personale nga Byroja e Kreditit ose Ofruesi i të dhënave të cilët janë të detyruar të përgjigjen pa vonesë të pajustificuar dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

E drejta për t'u njohur me informacionin kreditor

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të njihet me informacionin që përmban historiku i tij kreditor duke paraqitur një kërkesë pranë Byrosë përkatëse të kreditit, e cila duhet të japë informacionin e mëposhtëm:

- a) raportin kreditor të subjektit të të dhënave;
- b) burimet e informacionit dhe identitetin e ofruesve të të dhënave;
- c) identitetin e çdo përdoruesi të të dhënave që ka marrë një raport mbi subjektin e të dhënave.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës nga Byroja e kreditit.

3. Dorëzimi i informacionit ofrohet pa pagesë, një herë gjatë vitit kalendarik, si dhe kurdo që përdoruesi i të dhënave ka refuzuar të lidhë një marrëveshje kredie.

4. Pika 3 nuk kufizon të drejtën e aksesit sipas Ligjit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Neni 28

E drejta për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Byrosë së kreditit në rast të kundërshtimeve që kanë të bëjnë me vërtetësinë ose plotësinë e informacionit që përmban historiku i tij kreditor. Subjekti i të dhënave mund t'i bashkëngjitë ankesës çdo dokument të nevojshëm për të justifikuar kundërshtimet e tij.

2. Ankesa mund të bëhet nga vetë subjekti i të dhënave ose nga një person i autorizuar rregullisht prej tij.

3. Pas marrjes së një ankese nga një subjekt i të dhënave në lidhje me historikun e tij kreditor, Byroja e kreditit duhet të vendosë menjëherë një shënim për informacionin e kundërshtuar në dosjen përkatëse të subjektit të të dhënave. Ky shënim do të qëndrojë në dosjen e subjektit për aq kohë do të zgjatë procesi i verifikimit. Gjatë kësaj kohe, çdo raport kreditor i lëshuar për subjektin e të dhënave duhet të tregojë qartë ekzistencën e mosmarrëveshjes dhe vijimësinë e një procesi verifikimi.

4. Byroja e kreditit e rrëzon ankesën nëse pretendimet janë qartësisht të pabazuara dhe/ose subjekti i të dhënave nuk ka paraqitur ndonjë provë bindëse për të mbështetur pretendimet. Në këto raste, Byroja e kreditit njofton subjektin e të dhënave për rrëzimin e ankesës brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit.

5. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 4, Byroja e kreditit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së ankesës, njofton ofruesit e të dhënave që kanë dhënë qoftë dhe një pjesë të informacionit të kundërshtuar dhe u paraqet atyre pretendimet dhe provat e depozituara nga subjekti i të dhënave.

6. Ofruesi i të dhënave, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit nga Byroja e kreditit, shqyrton kundërshtimin e subjektit të të dhënave dhe i komunikon Byrosë së kreditit përfundimet me anë të një përgjigje të arsyetuar.

7. Nëse, pas vlerësimit dhe kontroleve të kryera për informacionin e kundërshtuar, konfirmohet se të gjitha ose një pjesë e të dhënave janë të paplota dhe/ose të pasakta ose saktësia ose plotësia e tyre mbetet e dyshimtë, Byroja e kreditit duhet të fshijë menjëherë ose të pasqyrojë ndryshimet e nevojshme në informacionin përkatës në historikun kreditor, dhe të njoftojë njëkohësisht subjektin e të dhënave dhe ofruesin e të dhënave.

8. Procedura e parashikuar në këtë dispozitë nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga data e pranimit të ankesës në Byronë e kreditit. Vendimi i njoftohet subjektit të të dhënave jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së tij.

9. Byroja e kreditit nuk mund të rivendosë informacionin e fshirë ose të ndryshuar sipas kësaj procedure, me përjashtim të rastit kur janë paraqitur prova që konfirmojnë se informacioni është i plotë dhe i saktë. Në këtë rast, Byroja e kreditit njofton me shkrim subjektin e të dhënave për rivendosjen e informacionit, brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 29

Kufizimi i përpunimit të të dhënave personale

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë përpunimin e të dhënave të tij personale në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Në rast ushtrimi të së drejtës së kundërshtimit sipas pikës 1 të këtij neni, Byroja e kreditit ose përdoruesi i të dhënave pushon përpunimin e të dhënave personale, përveç rasteve kur provohet se ekzistojnë arsye të ligjshme bindëse që mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave, ose kur përpunimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

KREU VI

THEMELIMI, LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E BYROVE TË KREDITIT

Neni 30

Themelimi dhe regjistrimi i Byrove të kreditit

1. Subjektet që mund të themelojnë një Byro Krediti, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me subjekte të tjera, janë:

a) Personat juridikë, veprimtaria e të cilëve lidhet ngushtësisht me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit kreditor për persona fizikë dhe juridikë me qëllim vlerësimin e aftësisë së tyre kredituese.

b) Bankat dhe institucionet financiare jo-banka që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim me subjektet e përcaktuar në shkronjën “a”.

2. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni mund të marrin pjesë në kapitalin aksionar të një Byroje krediti, qoftë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, individualisht apo në mënyrë të përbashkët, por në asnjë rast pjesëmarrja e tyre e përgjithshme nuk mund të tejkalojë 49 për qind të kapitalit aksionar me të drejtë vote.

3. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “b” nuk mund të ushtrojnë kontroll mbi Byronë e kreditet, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, individualisht apo në mënyrë të përbashkët.

4. Kontrolli mbi Byronë e kreditet, në kuptim të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, ushtrohet nga një ose më shumë subjekte të përcaktuara në pika 1, gërma “a” të këtij neni.

5. Byrotë e kreditet regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit në formën e shoqërive aksionare.

6. Emri i shoqërisë aksionare duhet të përmbajë fjalët “Byro Krediti”, për të pasqyruar qartë funksionet e saj.

7. Pas regjistrimit si shoqëri aksionare, për të operuar si Byro krediti, shoqëria duhet të pajiset me licencë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila jepet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për licencat, autorizimet dhe lejet”, për grupin e dytë të licencimit.

Neni 31

Licencimi i Byrove të kreditet

1. Aplikimi për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si Byro krediti paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shoqëria që aplikon për licencë si Byro krediti duhet të jetë e themeluar në përputhje me kërkesat e nenit 30 të këtij ligji dhe të ketë në përbërjen e saj aksionare të paktën një subjekt të përcaktuar në nenin 30, pika 1, shkronja “a”.

3. Kërkesa për licencim duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Aktin e Themelimit të shoqërisë;

b) Ekstraktin historik nga regjistri tregtar për shoqërinë aksionare;

c) Ekstraktin historik të aksionarëve themelues;

ç) Certifikatë e gjendjes gjyqësore për aksionarët themelues dhe për anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë;

d) Për subjektet e përcaktuara në Nenin 30, pika 1, gërma (b), vërtetimin që janë subjekte të licencuara dhe zotërojnë licencë aktive për ushtrimin e veprimtarisë bankare ose të institucionit financiar jo-bankë;

dh) Për subjektet e përcaktuara në Nenin 30, pika 1, gërma (a):

- dokument që vërteton se disponojnë jo më pak se pesë (5) vite përvojë të vazhdueshme operacionale në fushën e përcaktuar në Nenin 30, pika 1, gërma (a), të ushtruar në Republikën e Shqipërisë, në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian ose në një nga vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD);
- pasqyrat financiare të audituara për tre (3) vitet e fundit;

- dokumente që provojnë se zotërojnë certifikim të vlefshëm sipas ISO/IEC 27001 ose një standardi tjetër të barasvlefshëm për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe ISO/IEC 27031 ose standard të barasvlefshëm që munësojnë vazhdimësinë e aktivitetit dhe rimëkëmbjen pas fatkeqësive.

4. Qendra Kombëtare e Biznesit shqyrton aplikimin dhe vendos për miratimin ose refuzimin e dhënies së licencës, në përputhje me kushtet, procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjin “Për licencat, autorizimet dhe lejet”.

5. Licenca jepet për një afat të pacaktuar dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Vendimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të ankimohej nga subjekti i interesuar sipas procedurës së parashikuar në ligjin “Për licencat, autorizimet dhe lejet”, i ndryshuar.

Neni 32

Transferimi i Aksioneve dhe Ndryshimi i Kontrollit

1. Transferimi i paketës kontrolluese të aksioneve të një Byroje Krediti nuk lejohet para kalimit të pesë (5) viteve nga data e dhënies së licencës. Pas përfundimit të kësaj periudhe, transferimi i paketës kontrolluese që sjell ndryshim kontrolli lejohet vetëm në favor të subjekteve që përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 1, shkronja “a”, si dhe kriteret përkatëse të licencimit të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji. Qendrën Kombëtare të Biznesit e konsideron kërkesën për regjistrimin e transferimit të pavlefshme dhe nuk procedon me regjistrimin e saj.

2. Çdo transferim i paketës kontrolluese që sjell ndryshim kontrolli dhe kryhet në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni është i pavlefshëm dhe përbën shkak për revokimin e licencës së Byrosë së Kreditit. Revokimi i licencës bëhet sipas nenit 29, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 33

Mbikëqyrja e veprimtarisë së Byrove të kreditit

Mbikëqyrja e veprimtarisë së Byrosë së Kreditit, për aq sa lidhet me të dhënat personale, kryhet nga Komisioneri në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.